



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-062

Prishtinë, më 3 qershor 2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 QERSHOR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Munguan: Aida Dërguti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Slavko Simiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy (2) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 11 dhe 25 maj 2016,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 11 dhe 25 maj 2016

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 11 dhe 25 maj 2016.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishëm në mbledhje, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 9 qershor 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-093 për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961),*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale,*
6. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-083 për falimentimin,*
9. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,*
10. *Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve,*

11. *Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,*
12. *Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,*
13. *Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015,*
14. *Shqyrtimi i raportit të punës së Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015,*
15. *Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.*

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. *Kërkesa e deputetes Alma Lama për lejimin e udhëtimit zyrtar në Vjenë (Austri), nga 28 qershor deri më 2 korrik 2016*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Alma Lama, për të marrë pjesë në Forumin e Crans Montanës, me temë: “Nga Evropa Qendrore deri në Lindje”, i cili do të mbahet në Vjenë (Austri) nga 28 qershori deri më 2 korrik 2016.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, si dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. *Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Hungari, nga data 04-06 maj 2016*

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Hungari, nga 4-6 maj 2016.

4. Të ndryshme

1. *Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për furnizim me dhurata*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbulimi i shpenzimeve për blerjen e dhuratave në vlerë prej 2 500 euro lidhur me udhëtimet që do t'i realizojë kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, në Vjenë, në Londër dhe në Bullgari, si dhe për “Lutjet e Mëngjesit”, që do të organizohen këtë vit në Kosovë.

2. *Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Adem Grabovci, Ganimete Musliu, Besa Gaxheri dhe Safete Hadërgjonaj, për të marrë pjesë në Tubimin Ndërkombëtar XXI, i cili do të mbahet në Berlin (Gjermani), prej 8-12 qershor 2016.
2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, për regjistrim në takim, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. *Ankesa e z. Darko Dimitrijeviq lidhur me vendimin e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës për emërimin e drejtorit të RTK 2*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me ankesën e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Kërkohej nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie që ta shqyrtojë ankesën e z. Darko Dimitrijeviq lidhur me vendimin e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës për emërimin e drejtorit të RTK 2.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*